URDHËR
Nr. 4211, datë 7.6.2007

MBI MASAT PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË QARKULLIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE, GJATË SEZONIT TURISTIK

(Ndryshuar me urdhrin nr. 4211/2, datë 12.7.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 6 të ligjit nr. 8378 datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Brendshëm

URDHËROJNË:

Në kuadrin e masave për sezonin turistik veror 2007 dhe në zbatim të detyrave të dala nga urdhri nr. 68, datë 24.4.2007 i Kryeministrit "Për përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të masave për sezonin turistik veror 2007" të merren këto masa:

1. Me qëllim të lehtësimit të trafikut në disa akse rrugore të cilat kalojnë në zonat turistike, të pezullohet përkohësisht qarkullimi i mjeteve të transportit të mallrave, që kanë peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 ton, përjashtuar mjetet frigoriferike që kanë peshë maksimale me ngarkesë deri në 5 ton.

2. *Pezullimi i qarkullimit të bëhet në segmentet rrugore kombëtare, si:*

a) Shkodër-Velipojë,

b) Vlorë-Himarë-Sarandë-Butrint.

3. Pezullimi i qarkullimit do të bëhet vetëm për periudhën nga 15 korriku, deri më 31 gusht 2007, prej orës 8 ºº deri në orën 22 ºº.

4. Transporti i mallrave me mjete, që kanë peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 ton, gjatë kësaj periudhe, do të bëhet nga ora 22 ºº deri në orën 8 ºº.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masa të menjëhershme për vendosjen e sinjalizimit rrugor të nevojshëm.

6. Në zbatim të pikës 5 të nenit 6 të Kodit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, kryetari i këshillit të qarkut dhe kryetari i komunës ose bashkisë, shpallin urdhëresa për zbatimin e këtij urdhri, për rrugët nën juridiksionin e tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prefektët, drejtoritë e policisë në qarqe, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

8. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit për Transportin dhe Telekomunikacionin në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Prefekturave në Ministrinë e Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani